

<p style="text-align: center;"><b>DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON PRIVATIZATION AGENCY RELATED MATTERS</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>SPECIJALNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA ZA PITANJA KOJA SE ODOSE NA KOSOVSKU AGENCIJU ZA PRIVATIZACIJU</b></p>
-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

**SCEL – 11 – 0005**

*Ankuesi*

**Z.P.**

*Përfaqësuar nga Avokat T.B.*

*Kundër*

*E Paditura*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit**

Rr. Ilir Konushevcu nr. 8, Prishtinë

Kolegji i specializuar 1 i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i përbërë nga Esmë Erterzi, Gjyqtare Kryesuese, Shkelzen Sylaj dhe Hysen Gashi Gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 03.06.2013, lëshon këtë:

### **AKTGJYKIM**

**Ankesa e Z.P. refuzohet si e pabazuar.**

#### **Rrethanat faktike dhe procedurale:**

Ankuesi pohon se është ish-punëtorë i Ndërmarrjes Shoqërore NSH “M.” në G., e cila është privatizuar nga e Paditura.

Data e privatizimit të NSH “M.”, G., ishte 15 Qershor 2006.

Lista përfundimtare e punëtorëve me të drejta legjitime është publikuar me datë 09,10 dhe 11 dhjetor 2010 në gazetën Koha Ditore dhe Blic dhe se afati për paraqitjen e ankesave ka qenë 20 (njëzet) ditësh nga dita e fundit e shpalljes së listës finale.

Më 20 dhjetor 2010, ankuesi parashtrori një ankesë pranë Dhomës së Posaçme kundër AKP-së duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve të kualifikuar për të marrë pjesën e të ardhurave nga privatizimi i NSH “M.” në G. Ankuesi ka pohuar se ai ka punuar në NSH deri me 12.06.1999. Ai thekson se librezën e punës i ka mbetur në ndërmarrje sepse ai e ka lëshuar G. dhe Kosovën. për shkak të sigurisë personale dhe familjare. Bazën ligjore e mbështet në ligjin kundër diskriminimit.

Në vërejtjet me shkrim të datës 24.01.2011, AKP-ja ka pohuar se ankesa duhet të refuzohet si e pabazuar. Ankuesi nuk ka prezantuar librezën e punës apo ndonjë provë tjetër relevante për të vërtetuar se ka qenë në marrëdhënie punë në NSH “M.” apo ka

qenë në listën e pagave të punëtoreve në kohën e privatizimit dhe se nuk i ka mbështetur pretendimet e tij me prova materiale për diskriminim.

Me 15.06.2011 AKP është përgjigjur në urdhrin e DHP të datës 31.05.2011, duke bashkangjitur hollësitë lidhur me komisionin për shqyrtimin e listës së punëtorëve, memorandumit si dhe listën e publikimeve zyrtare.

Me 10.04.2013 AKP është përgjigjur në urdhrin e DHP, me të cilin i ishte kërkuar që të deklarohet lidhur me datën e privatizimit të NSH "M" në G.

Me 17.04.2013 gjykata lëshoj një urdhër dhe e ftoj ankuesin për seancën dëgjimore me 24.04.2013 por ankuesi nuk u paraqit, ndërsa e paditura AKP po.  
Për ankuesin nuk ka fletë kthesë se a e ka pranuar ftesën për seancë.

Me 23.04.2013 Gjykata me një urdhër bëri delegimin e përgjegjësive të trupit gjykues tek gjyqtari i vetëm, vetëm sa i përket mbledhjes së provave dhe mbajtjen e seancës dëgjimore.

Me 24.04.2013 gjykata i dorëzoi ankuesit vërejtjet me shkrim të paraqitura nga AKP, dhe kërkoj nga ai që të parashtroj dëshmi në lidhje me marrëdhënien e tij të punës pran N.SH M. në G.

Me 24.04.2013 përfaqësuesi i ankuesit u përgjigj ndaj vërejtjeve të AKP-së duke pohuar të njëjtat thenje të cilat i kishte paraqitur në ankesën e datës 20.12.2010, duke shtuar se e paditura nuk e ka kontestuar se ankuesi ishte drejtor i N.SH, andaj ka propozuar që ankesa e ankuesit të aprovohet.

Për detaje tjera referim bëhet tek dosja e lëndës në Dhomën e Posaçme

### **Arsyetimi ligjor:**

Aktgjykimi është marrë pa mbajtur seancë dëgjimore pasi që faktet dhe argumentet ligjore janë dërguar mjaftë qartë. Kolegji nuk pret informacion tjetër relevant dhe argumente tjera në ndonjë seancë dëgjimore. Neni 68.11 i Shtojcës së Ligjit mbi Dhomën e Posaçme 04/L-033- LDHP).

Ankesa e ankuesit është e pa bazuara.

Neni 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, i ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/45, përcakton kërkesat që një punëtor duhet t'i plotësojë në mënyrë që të konsiderohet si i kualifikuar, ndërsa neni 10 përcakton procedurën për parashtrimin e ankesës pranë Dhomës së Posaçme si në vijim:

*"10.4 Sipas këtij neni, punëtori konsiderohet si legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes në pronësi shoqërore në kohën e privatizimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tri (3) vite. Kjo kërkesë nuk i ndalon punëtorët, të cilët pretendojnë se edhe ata do të ishin regjistruar apo punësuar, nëse nuk do të kishin qenë diskriminuar, që të paraqesin ankesë në Dhomën e Posaçme, në pajtim me paragrafin 10.6."*

Gjykata përmes urdhrin të datës 24.04.2013 i dha mundësi ankuesit që të parashtroj dëshmi në lidhje me marrëdhënien e tij të punës në N.SH, mirëpo në përgjigjen e tij ai nuk

ofroj asnjë dëshmi për të vërtetuar se ai ishte punëtor i N.SH "M.", G, përveç pohimit të tij se ka qenë punëtor në ndërmarrje deri me 12.06.1999.

Vetëm pohimi i tij në ankesë nuk mjafton në qoftë së ajo nuk provohet me argumente të dokumentuar, siç është librezja e punës apo dëshmi tjera të shkruara të cilat vërtetojnë se ankuesi ka qenë punëtor në NSH "M." në G.

Pretendimi i ankuesit se e paditura në vërejtjet e datës 24.01.2011 nuk ka kontestuar se ankuesi ishte drejtor nuk qëndron sepse e paditura ne po ato vërejtje ka kontestuar duke theksuar se ankuesi nuk ka prezantuar ndonjë provë materiale për të vërtetuar se ishte në marrëdhënie pune në N.SH "M".

Meqë gjykata nuk mundi të vërtetoj se ankuesi ka pasur të themeluar marrëdhënie pune tek NSH, si e tillë ajo nuk u lëshua në konstatimin e diskriminimit.

### **Taksat Gjyqësore:**

Gjykata nuk i cakton shpenzimet për ankuesit pasi që Presidiumi i Gjykatës, deri në këtë datë, nuk ka nxjerrë ndonjë plan me shkrim i cili është miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (neni 57, paragrafi 2 i Shtojcës së Ligjit për Dhomën e Posaçme). Kjo do të thotë se deri me tani nuk ka bazë të mjaftueshme ligjore për caktimin e shpenzimeve.

### **Këshilla Juridike:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet Ankesë brenda 21 ditësh tek Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme. Ankesa duhet t'u dërgohet edhe palëve tjera dhe të dorëzohet tek Trupi Gjyku nga ankuesi brenda 21 ditësh. Ankuesi duhet të dorëzojë tek Kolegji i Apelit dëshminë se e ka dërguar Ankesën tek palët e tjera.

Afati i paraparë fillon në mesnatën e asaj dite kur ankuesit i është dërguar aktgjykimi me shkrim.

### **Kolegji i Apelit e refuzon ankesën si të papranueshme nëse ankuesi nuk e parashtron atë brenda afatit të paraparë.**

E paditura mund të parashtrojë përgjigje tek Kolegji i Apelit brenda 21 ditëve nga data kur i është dërguar ankesa, duke e dorëzuar përgjigjen e saj tek ankuesi dhe tek palët tjera.

Ankuesi pastaj i ka 21 ditë afat pasi që t'i dërgohet përgjigja në ankesën e tij, për ta dorëzuar përgjigjen e tij tek Kolegji i Apelit dhe tek pala tjetër. Pala tjetër pastaj i ka 21 ditë afat pasi që t'i dërgohet përgjigja e ankuesit që të dorëzojë kundërpërgjigjen e tij tek ankuesi dhe tek Kolegji i Apelit.

Esma Erterzi, Presiding Judge  
Gjyqtare Kryesuese